# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-466589**
VERSIONI 2

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VIDEO/ Momenti kur pjesëtarët e grupit të Radoiçiçit sulmojnë Policinë e Kosovës me antitank |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/video-momenti-kur-pjesetaret-e-grupit-te-radoicicit-ojne-policine-e-k-i105860` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 16:08:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 16:03:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `873862b291bfb87025313e7e13162380c1ea9744657f026ec1a6b48a561e2818` |
| TEKSTI | `d21acdfe7f2cfbf3601fafa6a1cc3236f851ea857d2015c640ca011cbe58df8e` |
| PAMJA | `479e6802256a7f268dc0fad04a37f4bcd5755cd7183658d5a63effc0c7a25eb3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e84a418d32a0f2e53909339f026581075aeaf5685792efadd420fa67c7f41530` |
| E MËPARSHMJA | `43f0fdd93ce8d903da3ef06af309b3bb079a75742222a97d2bdd0135dd74e56e` |
| RRËNJA MERKLE | `e5d36276bdac6f0efd80a0011f78966ff078cd5aec9cbe323cc4b585e15f691e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e84a418d32a0f2e53909339f026581075aeaf5685792efadd420fa67c7f41530`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# VIDEO/ Momenti kur pjesëtarët e grupit të Radoiçiçit sulmojnë Policinë e Kosovës me antitank

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 18:03



Në trevjetorin e sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, rikthehen në vëmendje pamjet që dokumentojnë momentet kur pjesëtarë të grupit të udhëhequr nga Milan Radoiçiq sulmojnë Policinë e Kosovës.

Në pamjet e regjistruara gjatë sulmit të 24 shtatorit 2023 shihen pjesëtarë të armatosur të grupit duke përdorur armatim të rëndë gjatë përballjes me pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Në një prej sekuencave shihet edhe përdorimi i armës antitank të tipit “Zola” në drejtim të pozicioneve të Policisë së Kosovës.

Sulmi në Banjskë nisi në orët e hershme të 24 shtatorit 2023, pasi një grup i armatosur sulmoi pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Gjatë sulmit u vra rreshteri Afrim Bunjaku, ndërsa një polic tjetër u plagos.

Pas përleshjeve që pasuan, tre pjesëtarë të grupit të armatosur serb u vranë, ndërsa pjesa tjetër u tërhoq nga zona.

Milan Radoiçiq, atëkohë nënkryetar i Listës Serbe, mori publikisht përgjegjësinë për organizimin dhe pjesëmarrjen në sulm.

Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti në shtator të vitit 2024 aktakuzë ndaj 45 personave për rastin Banjska, duke e identifikuar Radoiçiqin si një nga figurat kryesore të grupit të akuzuar.

Pamjet e publikuara nga dita e sulmit tregojnë shkallën e armatimit me të cilin grupi kishte hyrë në Banjskë dhe intensitetin e përballjes me Policinë e Kosovës.

Tri vjet pas sulmit, Radoiçiq vazhdon të ndodhet në Serbi, ndërsa ndaj tij atje ende nuk është ngritur aktakuzë për sulmin e 24 shtatorit 2023.



## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 24 Shtator16:37

**Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiçit dhe asaj studentore**

Zgjedhjet parlamentare në Serbi, të caktuara për 25 tetor, rikthyen në vëmendje edhe politikën e Beogradit zyrtar ndaj Kosovë...

KOSOVA 24 Shtator13:40

**Nga bllokimi i rrugës me kamionë, tek tërheqja në male, si ndodhi sulmi i Banjskës**

Më 24 shtator 2023, në fshatin Banjskë të Zveçanit, në veri të Kosovës, ndodhi përplasja më e rënd&eu...

KOSOVA 24 Shtator09:53

**Tre vjet nga sulmi në Banjskë, Kurti: Ngadhënjyem mbi agresionin e krimin. Terroristët e Beogradit kishin qëllim aneksimin e veriut**

Në trevjetorin e sulmit të armatosur në Banjskë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kujtuar policin Afrim Bunjaku, i cili u vra ...

KOSOVA 24 Shtator08:15

**Mbi 15 miliardë euro për 18 vjet: Dërgesat e mërgatës në Kosovë arrijnë në 692 mln euro për gjashtë muaj**

Remitancat në Kosovë janë rritur me 5.7 për qind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, ndërsa gjatë periud...

KOSOVA 23 Shtator21:46

**Nata e tetë e protestës “Jo në emrin tim”, qytetarët mbushin sheshin “Skënderbeu”**

Qytetarë të shumtë janë mbledhur sërish sonte në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, ku po mbahet nata e...

KOSOVA 23 Shtator19:49

**Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi i përgjigjen Haxhiut pas ftesës për takim**

Familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kanë publikuar një letër të përbashkët, përmes së cil...

KOSOVA 23 Shtator15:33

**Kushtetuesja rrëzon opozitën, njeh Qeverinë e re të Kosovës. 6 tetori, afati i fundit për zgjedhjen e presidentit**

Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se Kuvendi i Kosovës është konstituuar përtej afatit 30-ditor, por megjithatë shtoi se deputet&e...

KOSOVA 23 Shtator09:02

**“Koha për të ecur përpara”/ Kallas takon Kurtin dhe Vuçiç: Marrëveshjet e dialogut, përfshirë atë të Ohrit, janë të detyrueshme**

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka zhvilluar takime të ndara me kryemin...

KOSOVA 22 Shtator23:26

**Maqedonia e Veriut arreston ish-luftëtarin e UÇK-së**

Fadil Pushkolli, një ish-luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka njoftuar se është arrestuar nga autoritetet e Ma...

KOSOVA 22 Shtator22:29

**Nata e shtatë e protestës, mijëra qytetarë sërish në shesh kundër vendimit të Speciales**

Për të shtatën natë radhazi, mijëra qytetarë janë mbledhur në sheshin “Skënderbeu” në Prishtin&eum...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

**U vra nga pronari italian i banesës, del autops...**

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...]

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në nj&eum...

AKTUALITET 23 Shtator

[“Ergys Agasi filmonte video gjatë takimeve në z...]

Gazetarja Anduena Llabani, ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtoresha ...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro]

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

## video



### PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.